



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK KAVAJË**

VENDIM

Nr. 08 Datë 26 / 03 /2025

**Për "MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QË
DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI, PËR
VITIN 2025"**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 për "Për Pyjet", të ligjit nr.8756 datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile", VKM-së nr.288 datë 27.06.2022 "Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundër zjarrit dhe shpëtimin në objekte me rëndësi ekonomike dhe shtetërore", VKM-së nr. 290 datë 30.04.2004 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Zjarreve në Pyje dhe kullota, VKM-së nr.835 datë 03.12.2004 "Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile", është hartuar programi i punës "Për parandalimin dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për periudhën nga muaji qershor deri në fund të vitit 2025".

Në pyjet me vlera të veçanta turistike, në zonat bregdetare, të merren masa suplementare shërbimi kundër zjarrit, sidomos në ditët e shtuna dhe të diela, duke disiplinuar lëvizjen e mjeteve, vizitirëve dhe pushueseve. Në vende të dukshme të vendosen tabela të posaçme për mbrojtjen nga zjarri. Në çdo Njësi Administrative përcaktohen skuadra vullnetare për shuarjen e zjarreve që përbëhen nga tre ose pesë vetë, të grupuar për një veprim të shpejtë dhe efektiv, për pyjet në zonat e Helmasit, Golemit, Luzi Vogël dhe Synej. Njësia Administrative Helmës, është ajo njësi e cila përshkohet gati për çdo vit nga rënia e zjarrit. Duke qenë se ka më shumë parcela me kullota, për ta parandaluar sensibilizojmë banoret e zonës duke mos ndezuar zjarre afër pyjeve dhe kullotave, gjithashtu dhe duke vendosur tabela.

Referuar pikës 4 germa c të nenit 30 të ligjit nr.57/2020 datë 30.04.2020 për "Për Pyjet", ky program duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak Brenda muajit mars të çdo viti.

Për sa më sipër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të radhës:

VENDOSI:

1. Të japë pëlqimin, për miratimin e programit të punës, Për parandalimin dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2025, e cila ndodhet bashkelidhur në projekt-vendim.

2. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjeditit, Drejtoria Ekonomike, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.



**KRYETAR
RUDIN HYLVIU**



Sekretari i Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miratuar me vota	<u>23</u>
Vota Pro	<u>23</u>
Vota Kunder	<u>-</u>
Vota Abstenim	<u>-</u>
Zbardhur me datë	<u>27/03/2025</u>